



Pranuar / Dorezuar Prunjaso/Prodate Received/Delivery	28 - 09 - 8	viti god year	
Organi/Njësia Org./Unit	Mr.Prof: Pr.Prof: Prof.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHK	5599/2018		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.560/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Gjylinaze Gola-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Lulzim Aliaj-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.560/2018 të datës 31.08.2018 të parashtruar nga ankuesja Drita Hajdari, me adresë fshati "Dobroshevc" në Komunën e Drenasit, kundër organit të punësimit/Komuna e Drenasit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.09.2018, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.560/2018 të datës 31.08.2018 të parashtruar nga ankuesja Drita Hajdari.

A r s y e t i m

Ankuesja Drita Hajdari, ka aplikuar në konkursin për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta të datës 14.06.2018 për pozitën "Zyrtar për Shërbime të Transportit Lokal" të shpallur nga komuna e Drenasit, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Komuna e Drenasit më datë 15.08.2018 nëpërmjet njoftimit me Nr. 01-111-26035 ka bërë anulimin e konkursit, ankuesja kundër këtij njoftimi më datë 16.08.2018 ka parashtruar ankesë me Nr. 01-111-48853 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Drenasit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Drenasit, më datë 22.08.2018 nxjerr Njoftim me Nr. 01-111-48853, lidhur me ankesën e ankuseses.

Ankuesi, bazuar në Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.08.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4999/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me anulimin e konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.09.2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Komuna e Drenasit. Komuna e Drenasit më datë 24.09.2018 ka dërguar përgjigjen në ankesën e ankueses.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4999/2018 e datës 31.08.2018 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 16.08.2018 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimin për anulim të konkursit i datës 15.08.2018; Njoftimi i datës 29.06.2018; Njoftimi i datës 13.07.2018; Reference zyrtare e datës 23.10.2017; Njoftimin me Nr. 01-111-48853 i datës 22.08.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Drenasit Diplomën me Nr. 684 të ankueses; Zarfën e Postës i datës 28.08.2018; Konkursin për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta të datës 14.06.2018 për pozitën “Zyrtar për Shërbime të Transportit Lokal” të shpallur nga komuna e Drenasit; Fletë dorëzimit e datës 23.08.2018; Testin me shkrim i datës 06.07.2018; Formularin për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues datë 20.07.2018; Kërkesën për punësim të ankueses së bashku me dëshmitë për përgatitje profesionale dhe përvojën e punës dhe Përgjigjen në ankesë e datës 24.09.2018 me numër protokoll 5478/2018 e dërguar nga Komuna e Drenasit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja Drita Hajdari, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar që Komuna e Drenasit konkursin për pozitën “Zyrtar për Shërbime të Transportit Lokal” në të cilin ka aplikuar edhe ankuesja e ka shpallur për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se pozitën me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta nuk hyjnë në kategorinë e pozitave të shërbyesve civil apo të punësuarve në shërbimin civil, sepse marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhet në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve siç përcaktohet me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtë se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrime...”*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas shqyrtimit të lëndës, dhe bazës ligjore të aplikuar në lidhje me këtë çështje administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses Drita Hajdari;
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Drenasit;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.560/2018.

Gjylinaze Gola
Kryetare e Kolegjit



Avdyl Bekteshi
Procesmbajtës

